

01 SHKURT 2022

## MË 1 SHTATOR HAPET THIRRIA PËR MBËSHETJETEN NGA SKEMA KOMBËTARE



Më 1 shtator hapet thirrja për mbështetjen nga Skema Kombëtare të mbjelljeve të reja të grurit. Masa e mbështetjes do të jetë në 30.000 lekë për hektarë.

Për herë të tretë brenda vitit, fermerët do të marrin mbështetje të drejtpërdrejtë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frída Krifca në një takim me fermerët në Maliq të Korçës, njoftoi shtesën e radhës që i vjen buxhetit të skemës kombëtare brenda vitit, kësaj herë për kulturën e grurit me 1.2 miliardë lekë të tjera, nga të cilat 500 milionë lekë për grurin duke e cuar buxhetin total të mbështetjes së drejtpërdrejtë për fermerët në pothuajse 4 miliardë lekë. Ministria nënvizoi se kjo mbështetje për të tretën herë radhazi nuk nuk ka ndodhur më parë dhe se fokusi i qeverisë shqiptare është fuqizimi i prodhimit vendas në kulturën e grurit.

### GATI REGJISTRI I FERMERIT!

Regjistri i Fermerit është instrumenti i ri në dorë të fermerëve tanë për të mundësuar protokolle dhe gjurmueshmëri të prodhimit cilësor bujqësor për konsumatorët, për të qenë më të sigurtë në tregun vendas dhe ndërkombëtar. Agronomët e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve ndodhen në terren për të asistuar fermerët me këtë plan të ri.

Regjistrimi i të dhënave për produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB) të përdorura në fermë si dhe numri e data e spërkatjes apo intervalet e sigurisë janë protokolle absolutisht thelbësore për konsumatorët mbi sigurinë ushqimore të produkteve bimore fundore, për sigurinë e shëndetit të fermerëve, për mbrojtjen e mjedisit si dhe rritjen e besueshmërisë së eksporteve shqiptare.

### RITEN EKSPORTET BUJQËSORE TË 7 MUJORIT 2022

**+48 MLN EURO MË SHUMË**



7 MUJORI 2021 7 MUJORI 2022

Eksportet bujqësore në 7 mujin e vitit 2022 kanë qenë në rritje. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frída Krifca ndau në rrjetet sociale të dhënat e eksporteve, duke bërë me dije se në krahasim me një vit më parë kemi pasur 48 mln më shumë produkte bujqësore të eksportuara. Referuar shifrave të vitit të kaluar, eksportet në 7 mujin e vitit 2021 kanë qenë 216 mln euro, ndërkohë që e njëjta periudhë e këtij viti ka arritur shifrën e 264 mln euro.

### MINISTRJA KRIFCA NË LEZHË PËR NJË ANALIZË PERFORMANCE TË INSTITUCIONEVE NË VARËSI.

Në Lezhë, ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Frída Krifca ka zhvilluar një takim me ekipin e bujqësisë në këtë qark, duke kryer edhe një analizë performance dhe bilanc të shërbimit ofruar nga institucionet evarësisë ndaj fermerëve, blegtorëve, bletarëve, peshkatarëve, agropërpunuesve dhe konsumatorëve në qark.

Me komunikim të hapur tha ministria mund të njihen nevojat në territor, por edhe të realizohen objektivat e bujqësisë që duam. Pavarësisht nëse punohet në Ujitje Kullim, në Ekstension, në Veterinari, në AKU apo AZHBR, predispozita është për t'i qendruar pranë fermerëve dhe biznesit në zbatim të politikave të një bujqësie të integruar dhe zhvilluar.

### Universiteti BOKU do të jetë partner strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Universiteti i Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës, Vjenë (BOKU) do të jetë partner strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe do të shërbejë si një model orientues për objektivat, veçanërisht në drejtim të ndërkombëtarizimit të strukturave dhe ofertës akademike Kryeministri Edi Rama, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frída Krifca si dhe rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fatbardh Sallaku, zhvilluan një takim me rektoren e re të Universitetit BOKU, prof. Schulev-Steindl. Dy universitetet do të bashkëpunojnë në të gjithë nivelet e ofrimit të djes si mësimi, kërkimi shkencor, transferimit të njohurive dhe teknologjive bujqësore, digjitalizimit, reformimit institucional dhe menaxhimit te universitetit.

### DJATHI "MISHAVINË" NJË PRODUKT 100% SHQIPTAR

Produktet tradicionale dhe autentike që janë shndërruar në "markë shqiptare", mbrohen tashmë duke u regjistruar si produkte me emërtim origjine të mbrojtur (EOM apo GI). Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frída Krifca, solli në rrjetet sociale shembullin e Valterit nga Kelmendi, Malësi e Madhe, që është një nga prodhuesit e djathit "Mishavinë". Krifca tha se "e fillojmë këtë regjistrim të parë me një produkt të Kelmendit - djathin "Mishavinë". Një produkt më shumë se 100-vjeçar, të cilin duke e mbrojtur si Produkt Origjine të Mbrojtur i ruajmë identitetin shqiptar, por dhe i japim vlerë".

### KRYEMINISTRI RAMA DHE MINISTRJA KRIFCA MARRIN PJESË NË FORUMIN EUROPIAN ALPBACH



Kryeministri Rama dhe Ministria Krifca kanë marrë pjesë në Forumin European Alpach ku përveç sesionit "Zgjidhje Gjeopolitike të BE" ku Kryeministri Rama mbajti fjalë, zhvilluan disa takime frytdhënëse, me Ministrin Austriak të Bujqësisë dhe Turizmit, Z. Norbert Totschnig, me Z. Martin Frick, Drejtorin për Programin Botëror të Ushqimit, Z. Franz Fischler, ish Komisioner për Bujqësinë për nëntë vite si dhe Presidentin Nderi të Forumit European Alpach. Në takime u diskutua mbi nxitjen e bashkëpunimit në bujqësi dhe zhvillim rural me Austrinë dhe bashkëpunimin mes Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Universitetit Boku të Vienës.